

STATUTI dhe AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“123 RENT” Sh.p.k

Mbeshtetur ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare”, ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i permirsuar (7/2022), sot me date 09 Maj 2023 me vullnetin e lire e te plote vendosem te **krijojme dhe miratojme statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “123 RENT” Sh.p.k**, me kete permbajtje

I.-DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 09 MAJ 2023 ne, themeluesit, ne mbeshtetje te legjistacionit Shqiptar, kryesisht ne ligjin nr.9901 dt. 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare”, i ndryshuar dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi ka perpiluar dhe nenshkruar statutin e Shoqerise si me poshte vijone :

Neni 1-Forma

Shoqeria “**123 RENT**” sh.p.k eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rrgullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjistacioni ne fuqi. Ky statut eshte perpiluar ne perputhje me legjistacionin shipetare dhe ka karakter te detyrueshem per nenshkruesit e tij, çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te, plotesohen nga legjistacioni shqiptar.

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuar “**123 RENT**” Sh.p.k, krijohet nga ortaket e saj,

Z. Amarildo Meraj i identifikuar me karte indentiteti **Nr.033422908** dhe **Nr.Personal: J10812060V** , i biri i Muharem, i datelindjes 12 Gusht 1991, lindur ne Ballsh dhe banues ne Kelcyre ne adresen: “Perenjasit 02250003,Bd.81, H,1, Kelcyre, Fshat Kelcyre, 6402”.

Neni 2 - Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte “**123 RENT**” Sh.p.k.

Neni 3 - Selia

Shoqeria “**123 RENT**” e ka seline ne adresen: Tirane,Zona Kadestrale Nr.8270, Rruga Margarita, Tutulani, Shk.1 Kati 1, Hyrja 1.

Neni 4 – Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.



II.-OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti i Veprimtarise se Shoqerise "123 RENT" Sh.p.k, do te jete : **Import-Export, Automjete, Pjese Kembimi per automjete. Agjensi turistike, shit-blerje biletash të transportit ajror, detar dhe tokësor. Transport mallrash dhe udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit, guida turistike, përkthyes. Veprimtari në fushen e hotelerisë, Makina me Qera. Ushtrim i veprimtarisë së këmbimit valutor, ushtrimi veprimtarise së agjentit të transferimit të parave, në emër dhe për llogari të subjektit financiar- jo bankë. Agjensi imobiliare si dhe prerjen e policave të siguracioneve të ndryshme. Çdo aktivitet tjetër që konsiderohet i dobishëm nga organi administrues i Shoqërise , që lidhet direkt apo indirekt me aktivitetin e mësipërm.**

Neni 6

Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te Ortakeve te saj.

Neni 7

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te krijojte filiale, dege e perfaqesi brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve ku do te ushtroje veprimtarine.

Neni 8

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit.

Per detyrimet e veta Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj.

III-MJETET E SHOQERISE

Neni 9

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren **2'000'000 (Dy Milion) Leke**. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne kuota sipas pjesemarrjes ne perqindje per secilin ortak, Shoqeria perbehet nga nje ortak i vetem dhe totali i kuotave te shoqerise eshte 1 (Kuote).

Kapitali themeltar i shoqerise zoterohet si me poshte :

- 1. Z. Amarildo Meraj**, Me cilesine e ortakut themelues, zoteron 1 kuote me vlere nominale 2'000'000 (Dy Milion) Leke qe perbejne 100% te kapitalit te shoqerise.

Neni 10

Kapitali i Shoqerise mund te shtohet me vendim te ortakeve te saj, vendim i cili duhet te depozitohet ne zyren perkatese. Aktiviteti ne kete shoqeri nuk i pengon ortaket te kene te drejta pronesia dhe aktivitet jashte kesaj shoqerie.

IV.-ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 11

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj duke u bazuar ne kete Statut dhe ne ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 12

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e saj financiare, me mjete e kredi te akorduara ne menyre te ligjshme. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi te shumes se mjeteve te investuara dhe te shumes se mjeteve te rezervuara.

Neni 13

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte ti perdore ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj.

Neni 14

Kapitali themeltar i shoqerise dhe kapitali i mevonshem mund te krijoje nje fond te vecante, qe mund te mbetet ne llogarine bankare te shoqerise. Fondet monetare te shoqerise do te perdoren ne perputhje me kete statut te shoqerise dhe ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Shoqeria do te celi llogari ne banke. Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, ne euro, usd e monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ana e ortakeve dhe administratoret e saj.

Neni 16

Shoqeria do te krijoje keto fonde: Fondi Themeltar, Fondi Rezerve , Fondi i Shperblimit. Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te krijoje edhe fonde te tjera. Fondi themeltar i shoqerise formohet nga Kapitali Themeltar si dhe mjetet qe do krijohen gjate aktivitetit ekonomik te saj.

Neni 17

Shoqeria shfrytezon fondin Themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet per investime te ndryshme ne interest e realizimit te qellimit te shoqerise, si dhe per te mbuluar rreziqet mbas shfrytezimit te fondit rezerve. Fondin Themeltar shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj afariste.

Neni 18

Fondi Rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit, qe ajo realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Ortakeve te saj. Fondi Rezerve shfrytezohet per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.



V.-ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 19

Organet drejtuese te shoqerise:

-Ortaket e shoqerise .

-Administratori i shoqerise per nje afat 5 (pese) vjet do te jete :

Z. Amarildo Meraj i identifikuar me karte indentiteti **Nr.033422908** dhe **Nr.Personal: J10812060V** , i biri i Muharem, i datelindjes 12 Gusht 1991, lindur ne Ballsh dhe banues ne Kelcyre ne adresen: "Perenjasit 02250003,Bd.81, H,1, Kelcyre, Fshat Kelcyre, 6402".

Neni 20

Ortaket e shoqerise ushtrojne keto funksione : Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit te veprimtarise se shoqerise dhe aktet e pergjithshme, vendime per ndryshimin e emertimit te shoqerise, te cilesise se saj, te objektit te veprimtarise, per shtim ortakesh , ndryshim administrator. Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise,miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise, vendos per ndryshimin e formes se organizimit te shoqerise. Vendos per mbylljen e veprimtarise dhe caktimin e likujdatoreve.Te gjitha keto funksione do te kryhen ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit "Per regjistrin tregtar".

Neni 21

Administratori i shoqerise ka keto detyra:

Organizimin e drejtimin e punes dhe veprimtarise se shoqerise, perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet. Mban pergjegjesi per zbatimin e ligjeve ne shoqeri si dhe per aktivitetin ekonomik te saj. Pergatit aktet qe jane kompetence te ortakeve te shoqerise. Merret me organizimin dhe drejtimin e shoqerise si dhe percakton strukturen, numrin, kualifikimin e punonjesve te shoqerise,perfaqeson shoqerine ne lidhjen e kontratave dhe kryen veprime te tjera juridike qe nuk jane kompetence te ortakut te vetem.

Neni 22

Ne mungese apo ne pamundesi te ushtrimit te funksionit te administratorit ate e zevendeson nje punonjes tjeter, qe caktohet nga ai vete me shkrim.

VI.-MENYRA DHE KUSHTET E PERDORIMIT TE FITIMIT.

Neni 23

Pas perballimit te detyrave qe ka shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhe shpenzimeve te tjera, fitimi neto i shoqerise qe i perket ortakeve te saj, mund ta perdorin ate lirisht sipas deshires se vet.

VII.-MARRDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA.

Neni 24

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut dhe Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise. Shoqeria lidh kontraten per marrjen ne pune te punonjesve sipas Kodit te Punes.

Neni 25

Punonjesi ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe disipline te punes. Ortaket, administratori dhe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, njohurive e pervojes se fituar e shkembyer ne kuadrin e shoqerise, fshehtesine e gjendjes financiare dhe burimeve te mallrave, identitetin e shumave e te ardhurave te saj, depozitave, te dhena te tjera qe organizimin e orientimin e shoqerise i konsideron sekrete te punes. Te dhenat e punes qe paraqesin sekretet e punes mund te behen te njohura peronave te tjere me lejen e administratorit te shoqerise. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes se marrdhenieve te punes me shoqerine.

VIII.-MBYLLJA E SHOQERISE.

Neni 26

Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk mund te perballohen me mjetet e ortakeve te kesaj shoqerie, te vena me rastin e themelimit te shoqerise, hapet procedura e likujdimit te shoqerise.

Neni 27

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit te shoqerise , emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeria ne likujdim e siper". Ne rast shperndarje te shoqerise, administratori vendos per menyren e likujdimit, ortaket caktojne nje ose disa likujdator, te cilet bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje detyrimet, qe ka ndaj personave te trete.

Neni 28

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten ortakeve te saj.

Neni 29

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te shqyrtohet dhe miratohet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 30

Ne rast vdekje te ortakeve, pasuria e tyre i kalon ne pronesi trashegimtareve ligjor ne perputhje me dispozitat ligjore per trashegimine. Administratori i shoqerise ka te drejte te emeruje avokat dhe ekonomist si dhe t'ju japi te drejta personave te tjere, qe veprojne ne emer dhe per llogari te tij sipas ligjeve ne fuqi.

IX.-DISPOZITAT E FUNDIT.

Neni 31

Shoqeria deklarohet e krijuar me vendimin e Ortakeve te shoqerise. Nga kjo dite fiton statusin e Personit Juridik.

Neni 32

Ndryshimet ne kete statut behen ne te njeten menyre e procedure me te cilen nxirret ky statut duhe zbatuar dispozitat ligjore perkatese.

Neni 33

Mosmarveshjet ne shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet do te zgjidhen prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor te qytetit ku i takon.

Neni 34

Ky Statut u perpilua ne tre kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKU THEMELUES

Amarildo Meraj

Amarildo Meraj

